



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 157 – Dhjetor – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje nga aktivitetet e muajit dhjetor-Hapja e nënkalimit në Dragobil, shtrimi i rrugëve në Temeqinë dhe vizitat e kryetarit Begaj, shërbimeve të kujdestarisë më 31.12.2016



Tabela e përmbajtjes

Shtallat drejt përfundimit, pritjet edhe furnizimi me lopë qumështore	3
Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”, shënoi ditën e shkollës.....	3
Nga sot fillon realizimi i vizitave sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës	4
Kryetari Begaj, priti Klubin e Futbollit “Drenoci”	5
Vazhdojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkolla	6
KPF dha tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të kuvendit	7
KKSB e vlerësoi sigurinë në Komunën e Malishevës	7
Asfaltohen rrugët në Temeqinë.....	9
Sqarim: Kalldaja në shkollën e Malishevës, nuk ka shpërthyer	9
Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e radhës.....	10
Janë bërë të gjitha përgatitjet për sezonin dimëror	11
Të rinjtë e Malishevës, fillojnë hartimin e politikave rinore.....	12
Nxënësit e SHMU “ Imer Krasniqi” vizituan institucionet lokale në Malishevë.....	12
Shkrimtari Mehdi Krasniqi, vazhdon ti furnizoj bibliotekat shkollore me libra	13
Begaj e Gecaj përruruan nënkalimin në Dragobil	14
Kryetari Begaj, mbajti takimin e dytë publik me qytetarë.....	15
U dha shfaqja edukative për fëmijë “Palaço i Ati, Palaço i Biri”	16
Kryetari Begaj, i falënderoi punëtorët shëndetësor për punën e tyre humane.....	16
Deputetja Bytyqi, shpërndau dhurata për fëmijët e çerdhes.....	17
Kryetari Begaj, vizitoi njësinë e KEDS-it në Malishevë.....	18
Begaj: Puna dhe suksesi, meritë e përbashkët	18
Kryetar i Komunës, takoi të gjithë punëtorët e administratës komunale	19
Hoti e Buzhala, sportistët e vitit të Malishevës	19
Komuna ndihmoi 277 familje me ndihma dhe ka dhënë 100 dhurata për fëmijë	20
Kryetari Begaj, vizitoi shërbimet emergjente në Malishevë.....	20



Shtallat drejt përfundimit, pritet edhe furnizimi me lopë qumështore

Malishevë, 2 dhjetor

Projekti për ndërtimin e shtallave, ka hyrë në fazën finale, pasi dhjetë shtallat e parapara, janë ndërtuar, ndërsa edhe furnizimi me lopë qumështore është drejt finalizimit. Disa nga fermerët përfitues, sot i ka vizituar drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Murat Hoxha, i cili edhe i ka informuar për ecurinë e mëtutjeshme të përfundimit të këtij projekti.

Sipas drejtorit Hoxha, janë ndërtuar dhjetë shtalla, ndërsa të dhjetë përfituesit, do të furnizohen edhe me nga pesë krerë lopë qumështore, duke ju ndihmuar kështu në hapjen e shtallave të reja dhe rrjedhimisht, përmes kësaj përkrahje edhe punësimin e një numri të caktuar, të atyre që angazhohen në këto shtalla.

“Investimi në bujqësi është investimi më me interes për zhvillimin ekonomik dhe rrjedhimisht edhe në rritjen e furnizimit të tregut dhe konsumimit të produkteve vendore”, tha drejtori Hoxha, sipas të cilit, investimet në bujqësi, do të vazhdojnë të mbesin prioritet për qeverinë Begaj, edhe në vitin tjetër.

Projekti i ndërtimit të shtallave, është realizuar në bashkëfinancim me dhjetë fermerët përfitues, ndërsa vet fermerët janë shprehur të kënaqur me ecurinë e realizimit të këtij projekti dhe presin që brenda vitit të fillojnë me punën e tyre në shtalla.

Sipas drejtorit Hoxha, kanë përfunduar të gjitha procedurat për furnizimin me lopë qumështore dhe pritet që shumë shpejt të realizohet edhe kjo pjesë e projektit të drejtorisë, dhe për këtë qëllim, është realizuar edhe kjo vizitë, në mënyrë që fermerët të jenë të informuar në tërësi, deri në realizimin e projektit.

Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi”, shënoi ditën e shkollës

Malishevë, 2 dhjetor



Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, në ditëlindjen e dëshmorit, emrin e të cilit e mban kjo vatër e arsimit profesional, ka shënuar ditën e saj. Në këtë ditë të shënuar, ku krahas nxënësve e mësimitdhënësve, morën pjesë edhe familjarë të dëshmorit, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i arsimit në Malishevë, Avdi Morina, të shoqëruar nga drejtorë tjerë komunal, komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Halil Morina, pjesëtarë të FSK-së, bashkëluftëtar të Kujtim Krasniqit, dhe qytetar të tjerë.

Me këtë rast u vlerësua jeta dhe veprimtaria e Kujtim Krasniqit, si dhe të arriturat e Qendrës së Kompetencës. Drejtori i Qendrës së Kompetencës “Kujtim Krasniqi”, Nazmi Zogaj, në fjalën e rastit, i ka përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë vatër shkollore që nga hapja e saj, e deri në ditët e sotme, përfshi edhe bizneset në Malishevë, që e mundësojnë mbajtjen e mësimit praktik. Drejtori Zogaj, shprehi mirënjohjen e përjetshme për dëshmorin Kujtim Krasniqi, dëshmorët e kombit dhe të gjithë bashkëluftëtarët e tyre, për lirinë që ja sollën vendit.

Ndërsa nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, në fjalën e rastit, e vlerësoi ngjarje të madhe ditën e shkollës, e cila reflekton punën, misionin dhe përpjekjet e kësaj vatre të diturisë, e cila është pjesë e kompetencave edukative dhe arsimore. Duke folur për emrin që mban shkolla, nënkryetari Mazreku tha se “është shembulli më i mirë, se si interpretohet atdhedashuria”.

Këtë ditë të veçantë për këtë vatër shkollore, e ka përshëndetur edhe zyrtari i agjencionit për arsim profesional, Jetmir Berisha.

Pas fjalimeve dhe programit artistik të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle, u ndanë edhe mirënjohje për nxënësin më të mirë, mësimitdhënësin më të mirë, kujdestarin më të mirë dhe punëtorin teknik më të mirë.

Nga sot fillon realizimi i vizitave sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës

Malishevë, 5 dhjetor

Duke filluar nga dita e sotme, do të fillojnë vizitat sistematike shëndetësore për nxënësit e shkollave. Kështu është bërë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të qeverisë



komunale në Malishevë, të drejtuar nga kryetari Ragip Begaj, e ku drejtorët e drejtorive komunale, kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre, si dhe realizimin e projekteve kapitale.

Drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, ka konfirmuar se janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe nga dita e sotme, është filluar me realizimin e vizitave sistematike shëndetësore në të gjitha shkollat e Komunës së Malishevës. Këto vizita shëndetësore, kryhen nga stafi profesional i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe janë vizita të rregullta në kuadër të kujdesit shëndetësor.

Ndërsa sa i përket investimeve kapitale, apo realizimit të projekteve kapitale, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë, se janë duke vazhduar me realizimin e disa projekteve, siç janë kanalizimet në Senik, Drenoc, Astrazup, Gurbardh, Llapçevë dhe disa fshatrat tjerë, si dhe ka filluar rregullimi i oborrit të shkollës në Vërmicë.

Në sektorin e bujqësisë, drejtori Murat Hoxha, tha se kanë përfunduar mbjelljet vjeshtore, ndërsa janë në pritje të nënshkrimit të kontratës për furnizim të fermerëve me lopë qumështore, fermer të cilët janë pjesë e projektit për ndërtimin e stallave.

Muaji dhjetor, është muaji i ardhjes së mërgimtarëve, dhe për këtë qëllim, edhe drejtorja e administratës së përgjithshme, është mobilizuar, në mënyrë që t'iu ofrojnë shërbimet e nevojshme komunale, sidomos në sektorin e ofiqarisë.

Aktivitet në kulturë, rini dhe sport, sipas drejtoreshës Blerta Krasniqi, janë drejt përmbylljes së aktiviteteve zyrtare për këtë vit, ndërsa drejtori i arsimit, Avdi Morina, ka bërë të ditur, se janë furnizuar dy biblioteka shkollare me libra, si rezultat i iniciativës së shkrimtarit Mehdi Krasniqi, e që është përkrahur edhe nga drejtorja e arsimit dhe drejtorja për kulturë.

Edhe drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, ka bërë të ditur se, se bashkë me drejtoritë tjera, janë duke i bërë përgatitjet për fillimin e vitit 2017, ndërsa janë drejt përfundimit të vitit buxhetor 2016.

Kryetari Begaj, priti Klubin e Futbollit “Drenoci”

Malishevë, 6 dhjetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, kanë pritur një pjesë të ekipit të klubit të futbollit “Drenoci” nga Drenoci, të



cilëve ju kanë uruar suksese në aktivitetet e tyre sportive, si dhe ju kanë premtuar mbështetje, ashtu sikur i mbështesin të gjitha klubet tjera në Malishevë.

“Unë ju dëshiroj suksese në aktivitetin e juaj, si futbollist të rinj dhe të së ardhmes dhe premtoj se brenda mundësive që kemi, do ta përkrahim klubin tuaj”, tha kryetari Begaj, i cili i përgëzoi edhe suksesin arritur në garat ballkanike në Shqipëri, ku KF “Drenoci”, për moshat U13 ka zënë vendin e tretë.

Edhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport Blerta Krasniqi, ju ka dëshiruar suksese klubit dhe tha se “brenda mundësive buxhetore të drejtorisë, edhe KF “Drenoci”, do të mbështetet në aktivitetet e tyre, sikur të klubet tjera, pavarësisht buxhetit të kufizuar”.

Përgjegjësi i këtij klubi Zeqir Krasniqi, tha se në klub janë mosha të ndryshme të të rinjve, ndërsa si klub janë aktiv në garat sportive, kryesisht regjionale, por sukseset me këto mosha të reja, janë të kënaqshme, sikur vendi i tretë në garat ballkanike, mirëpo kanë nevojë për përkrahje, në zhvillimin e aktiviteteve.

Vazhdojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkolla

Malishevë, 6 dhjetor

Sot ka vazhduar programi i drejtorisë për shëndetësi, për realizimin e vizitave sistematike në shkollat e Komunës së Malishevës. Këto vizita shëndetësore, kanë vazhduar sipas orarit të paraparë, në shkollën e fshatit Tërpezë, ndërsa për këtë qëllim, këtë shkollë, sot e ka vizituar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, së bashku me drejtorin për shëndetësi, Hajdin Berisha, të cilët e kanë vlerësuar si shumë të rëndësishme këto kontrolle shëndetësore të nxënësve në shkolla.

Vizitat sistematike shëndetësore, janë duke u realizuar nga stafi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishevë.

“Është shumë më rëndësi, jo vetëm për vet nxënësit, por edhe për prindërit dhe stafin e shkollave, që të mësojnë për problemet eventuale që mund të kenë fëmijët, përkatësisht nxënësit, dhe kjo është mënyra më e mirë për ti eliminuar problemet që mund të shfaqen për arsye të ndryshme”, tha nënkryetari Mazreku, i cili i përgëzoi stafin mjekësor për këtë punë që janë duke bërë, në shërbim dhe mbrojtje të shëndetit të fëmijëve.



Drejtori për Shëndetësi, Hajdin Berisha, tha se “Kjo mënyrë e realizimit të këtyre vizitave, realizohet sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) dhe me këtë, ne kemi një pasqyrë të qartë të gjendjes shëndetësore të fëmijëve, dhe kjo nuk bëhet vetëm për statistika, por për kujdesin institucional të shëndetit të fëmijëve”.

Nga ana tjetër, mjekët e QKMF-së, thanë se realizimi i këtyre vizitave, po shkon shumë dhe në këto dy ditë të para, nuk vërehen patologji të theksuara, apo shqetësuese tek nxënësit.

Në këtë projekt, përfshihen mbi katër mijë nxënës të shkollave fillore në Komunën e Malishevës.

KPF dha tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të kuvendit

Malishevë, 7 dhjetor

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesues Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku fillimisht u prezantuan anëtarët e rinj të komitetit, sipas vendimit të KK të Malishevës dhe më pas, pas shqyrtimeve, i ka dhënë tri rekomandime për mbledhjen e ardhshme të kuvendit.

Me vendim të KK të Malishevës, anëtar të rinj të KPF-së janë, Labinot Gashi (LDK), i cili zëvendëson një ish anëtar t KPFë-së, pastaj Behie Sertolli (NISMA) dhe Valon Hoti (LVV), të cilët janë anëtar të rinj të komitetit.

Pas shqyrtimeve të kërkesave drejtuar KPF-s, anëtarët e këtij komiteti rekomanduan për kuvend, kërkesën e disa zejtarëve për zgjatjen e afatit për shfrytëzimin e lokaleve ku ata zhvillojnë aktivitetet e tyre zejtare, pastaj kërkesa e një qytetari për ndërrim destinim të tokës, dhe rekomandimi i tretë ishte peticioni i fshatit Lladrovç, lidhur me një pëlqim për hapjen e puseve dhe hapjen e kanalit për gypat e ujitjes, e të cilin banorët e këtij fshati e kundërshtojnë.

KKSB e vlerësoi sigurinë në Komunën e Malishevës

Malishevë, 8 dhjetor



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka mbajtur sot mbledhjen e gjashtë të rregullt dhe të fundit për këtë vit. KKSB, e vlerësoi të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme dhe pa tendencë të prishjes, ndërsa në veçanti u diskutua situata e sigurisë për komunitete, ku gjithashtu u tha se nuk janë të diskriminuar dhe se nuk ka asnjë rast të evidentuar për ndonjë diskriminim apo kërcënim me motiv etnik.

Fillimisht, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i ka falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në ruajtjen e sigurisë për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, e në veçanti Policinë e Kosovës, për angazhimin e tyre në shërbim të sigurisë për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim.

Në raportimin e tij, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, tha se “ bazuar në raportet policore, ka rënie të rasteve me precedent penal, dhe atë në krahasim me vitin e kaluar ka një rënie prej 32 për qind të rasteve”. Kapiteni Morina, gjithashtu tha se Policia e Kosovës, është përgatitur edhe për këtë fundvit, përkatësisht festimet e fundvitit, si në komunikacion, po ashtu edhe në përdorimin e mjeteve piroteknike.

Tema të veçanta në mbledhjen e fundit të KKSB-së, ishte edhe situata e sigurisë për komunitetet pakicë dhe personat me aftësi të kufizuara. Në raportimin e zyrtares për minoritete dhe kthim, Edona Krasniqi, u tha se në Komunën e Malishevës, jetojnë 36 rom, 6 ashkali, 1 amerikan dhe 5 të padeklaruar, ku tre prej tyre janë të punësuar në sektorin publik. Në asnjë rast nuk janë regjistruar asnjë lloj i diskriminimit etnik apo kërcënimit. Këtë deklaram të zyrtares Krasniqi, e ka konfirmuar edhe Policia e Kosovës.

Ndërsa për personat me aftësi të kufizuar, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, tha se “komuna është u përpjekur që në vazhdimësi ta ndihmoj këtë kategori të shoqërisë, të cilën e kemi obligim”. Kryetari Begaj, konfirmoj se vetëm gjatë këtij viti, nga donatorët e ndryshëm, si mërgimtarët tanë, ashtu edhe nga një kompani gjermane, janë furnizuar me karroca, të gjithë ata që kanë pasur nevojë, ndërsa një pjesë e kësaj kategorie, është e punësuar në sektorin publik dhe trajtohen njëjtë, si çdo qytetar i komunës sonë.

Në këtë mbledhje, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, njoftoi për përmbytjet e muajit të kaluar, ku sipas tij, situata është menaxhuar mirë, ndërsa dëmet e shkaktuar janë rreth 100 mijë euro.



Asfaltohen rrugët në Temeqinë

Malishevë, 8 dhjetor

Në kuadër të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të Komunës së Malishevës, përkatësisht banorëve të fshatit Temeqinë, pas hapjes dhe krijimit të bazës së rrugëve në këtë fshat, dje dhe sot, janë duke u asfaltuar të gjitha rrugët brenda fshatit dhe lidhin lagjet me rrugën kryesore. Asfaltimin e rrugëve, sot e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtor.

“Ne jemi duke u munduar maksimalisht, që brenda mundësive tona buxhetore, ti plotësojmë nevojat dhe kërkesat e juaja, përfshi edhe Temeqinën, si njëri prej fshatrave më të largëta të komunë sonë. Ne po i rregullojmë këto rrugë, e ju ti gëzoni”, ju tha kryetari Begaj, banorëve të Temeqinës, gjatë vizitës së sotme.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, gjithashtu i ka uruar banorët dhe tha se drejtoria që drejton, është munduar maksimalisht të realizoj të gjitha projektet e planifikuara. “Këto rrugë kanë qenë jo vetëm planifikim, por në të njëjtën kohë edhe një obligim i yni për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës”, tha Morina.

Temeqina, është njëri prej fshatrave të largët të Komunës së Malishevës, ndërsa asfaltimi i rrugëve brenda lagjeve, është nevojë e kohës, për lëvizjen më të lehtë për të gjithë banorët, e sidomos për nxënësit, të cilët duhet të ecin nga shtëpitë e tyre, deri në shkollë. Me këto rrugë të rregulluara, pothuajse kompletohet infrastruktura rruge në Temeqinë.

Sqarim: Kalldaja në shkollën e Malishevës, nuk ka shpërthyer

Malishevë, 8 dhjetor

Gjatë ditës së djeshme, në disa nga mediat në vendin tonë, është plasuar një lajm për kinse shpërthimin e kalldasë në ngrohjen e Sh.M.U. “Ibrahim Mazreku” në Malishevë. Me qëllim të njoftimit të drejtë të opinionit, sqarojmë se: Gjatë ditës së djeshme, në shkollën e lartpërmendur, ka pasur një problem me ngrohjen, për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, nga ana e KEDS-it, por nuk ka pasur shpërthim në kalldanë e ngrohjes. Ndërprerja e furnizimit me rrymë, për katër orë, ka bërë që pompat e ujit, të mos jenë funksionale, dhe si rezultat është rritur



temperatura në kallda, kur për shkaqe sigurie, menaxhmenti i shkollës, ka kërkuar intervenimin e njësisë së zjarrfikësve, për ftohjen e kalldasë.

Në rregullimin e këtij problemi, është intervenuar menjëherë dhe kalldaja është kthyer në funksion gjatë ditës së sotme dhe funksionon normalisht.

Në asnjë rast nuk ka pas shpërthim të kalldasë, por vetëm avari si pasojë e mungesës së gjatë të energjisë elektrike.

Rregullimin e këtij problemi, e ka konfirmuar edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, Avdi Morina.

Me këtë rast, kërkojmë nga mediat, që të jenë më të drejta në informimin e publikut dhe të mos bien pre e të pavërtetave. Të gjitha drejtoritë përkatëse në Komunën e Malishevës, Zyra për Informim Publik, dhe menaxhmentet e institucioneve, shkollore apo shëndetësore, janë dhe do të jenë në shërbim të qytetarëve dhe mediave, për informim të drejt.

Vërejtje: Në foto e keni gjendjen e kalldasë, menjëherë pas problemit të shfaqur, që tregon se nuk bëhet fjalë për shpërthim, por për intervenim në ftohjen e kalldasë.

Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 8 dhjetor

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës, i drejtuar nga zv/kryesuesi Naser Malisheva, ka mbajtur takimi i njëmbëdhjetë të radhës, ku në fokus të këtij takimi, ishte raporti i drejtorisë komunale të urbanizimit, lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2016.

Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka raportuar para anëtarëve të këtij komiteti dhe ka konfirmuar se janë realizuar të gjitha projektet e parapara, sipas listës së investimeve kapitale. “Ne i kemi realizuar të gjitha projektet, që janë paraparë në listën e investimeve dhe në asnjë rast nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi të qytetarëve, apo komuniteteve”, ka thënë Morina.

Më pas, anëtarët e komitetit, ka bërë pyetje të shumta për drejtorin Morina, lidhur me investimet, pyetje në të cilat është përgjigjur ai.



Janë bërë të gjitha përgatitjet për sezonin dimëror

Malishevë, 12 dhjetor

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, që udhëhiqet nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në mbledhjen e sotme, gjatë raportimit të drejtorëve të drejtorive komunale, u tha se janë bërë të gjitha përgatitjet për sezonin dimëror, si në mirëmbajtjen e rrugëve, ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve komunale, ku në fund vit ka fluks më të madh të qytetarëve, kryesisht mërgimtarë që duhet t’iu ofrohen shërbime të shpejta.

Fillimisht kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, që të jenë më shumë të angazhuar në këtë fund të vitit, si në ofrimin e shërbimeve administrative komunale, ashtu edhe në mirëmbajtjen e rrugëve, por edhe në përfundimin e projekteve në të cilat për shkaqe të ndryshme, ka mundur të kenë vonesa eventuale.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Milazim Krasniqi, tha se “janë kryer të gjitha përgatitjet për sezonin dimëror, përkatësisht, mirëmbajtjen e rrugëve dhe pastrimin e borës”, ndërsa drejtori i administratës Hajrullah Mazreku, deklaroi se drejtoria është përgatitur për ofrimin e shërbimeve komunale administrative, pasi në fund vit ka fluks më të madh të qytetarëve që kërkojnë dokumente, përkatësisht ardhja e mërgimtarëve gjatë festave të fund vitit.

Edhe drejtori i Inspektoratit, Fadil Shala, ka treguar se inspektorët komunal, janë më aktiv në këtë periudhë në kontrollimin e mallrave, përkatësisht produkteve ushqimore, pasi konsumimi i ushqimit është më i madh, prandaj të gjitha marketet dhe dyqanet, do të inspektohen vazhdimisht për afatet e përdorimit të mallrave.

Sa i përket shpenzimit të buxhetit, drejtori për buxhet Vesel Krasniqi, tha se “qëndrojnë mirë në shpenzimin e buxhetit, përkatësisht realizimin e projekteve të parapara, dhe se drejtoria është duke u përgatitur për fillimin e vitit të ri buxhetor 2017”.

Situata shëndetësore në Malishevë duket e mirë, edhe pse ka fluks më të madh të pacientëve në QKMF, për shkak të gripit sezonal. Sipas drejtorit për Shëndetësi, Hajdin Berisha, “është rritur numri i pacientëve, si pasojë e gripit, por stafi mjekësor në QKMF, është mirë i përgatitur për tu përballur me këtë fluks, ndërsa ka pak vonesa të furnizimit me barna nga lista esenciale, të cilën e bën ministria”. Drejtori Berisha, po ashtu njoftoi se është duke vazhduar projekti i vizitave sistematike shëndetësore në shkollat e Komunës së Malishevës.



Drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, njoftoi se janë drejt përfundimit të aktiviteteve që i takojnë këtyre tre sektorëve, sikur edhe drejtori i arsimit Avdi Morina, gjithashtu bëri të ditur se janë drejt përgatitjeve për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të këtij viti shkollor.

Sa i përket sigurisë, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi, njoftoi se gjatë fundjavës janë regjistruar tri intervenime të njësisë së zjarrfikësve.

Të rinjtë e Malishevës, fillojnë hartimin e politikave rinore

Malishevë, 12 dhjetor

Përmes një punëtorie, përfaqësuesit e organizatave rinore të Malishevës, të organizuar dhe përkrahur nga OSBE misioni në Kosovë, në bashkëpunim me Komunën e Malishevës, kanë filluar hartimin e politikave rinore, përkatësisht Planin e Veprimit Rinor, 2017-2019. Në këtë takim, po marrin pjesë përfaqësuesit e të gjitha organizatave rinore që veprojnë në Malishevë.

Në hapje të punëtorisë, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, e falënderoi OSBE-në për përkrahjen e vazhdueshme, si dhe për organizimin e kësaj punëtorie, e cila ka rëndësi të madhe, në hartimin e planit të veprimit rinor. “Ky plan është me shumë rëndësi, pasi do të t’iu ndihmoj në orientimin e aktiviteteve rinore dhe kjo është jo vetëm në dobi të juve si të rinj, por është në dobi të shoqërisë në përgjithësi”, tha drejtoresha Krasniqi, e cila bëri të ditur, se përveç kësaj punëtorie, do të organizohet edhe një punëtori tjetër.

Ndërsa, Yusuke Hara, zyrtar i OSBE-së, tha se “kjo punëtori, është një diskutim për të ardhmen e juaj dhe zhvillimi i politikave për tri vitet e ardhshme, është bazë për zhvillim në të ardhmen dhe prespektivë”.

Më pas, zyrtari për rini, Mehdi Krasniqi, e prezantoi Planin e deritanishëm të Veprimit Rinor, 2014-2016, dhe i bëri një vlerësim të politikave rinore, ku i paraqiti të arriturat e këtyre planifikimeve, në mesin e tyre edhe futjen e një kodi të veçantë buxhetor për rini.

Nxënësit e SHMU “ Imer Krasniqi” vizituan institucionet lokale në Malishevë



Malishevë, 13 dhjetor

Në kuadër të realizimit të plan programit shkollor, nxënësit e klasave të shtata, të Shkollës Fillore dhe të Mesme të Ulët “Imer Krasniqi” nga Carralluka, sot ka vizituar institucionin e Komunës së Malishevës dhe institucionet tjera komunale, ndërsa janë pritur nga nënkryetari i komunës, Rexhep Mazreku dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, të cilët i kanë njoftuar me punën që bëhet në këto institucione.

Fillimisht nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i ka përshëndetur nxënësit dhe i ka njoftuar lidhur me punën dhe detyrimet që ka institucioni i komunës, në raport me qytetarët, si dhe për angazhimet që bën komuna, në raport me arsimin dhe me rininë. Nënkryetari Mazreku, gjithashtu, është përgjigjur edhe në pyetjet që i janë bërë nga nxënësit e kësaj shkolle.

Nxënësit, i ka pritur edhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, e cila i ka njoftuar lidhur me aktivitetet e drejtorisë që ajo drejton, si dhe mundësitë që ka Komuna e Malishevës, në këto tri fusha.

Më pas nxënësit së bashku me drejtoreshën Krasniqi, i kanë vizituar edhe institucionet tjera, siç janë muzeu dhe biblioteka, ku janë njoftuar lidhur me natyrën e punës së këtyre institucioneve dhe qëllimin që kanë këto dy institucione.

Shkrimtari Mehdi Krasniqi, vazhdon ti furnizoj bibliotekat shkollore me libra

Malishevë, 14 dhjetor

Sot, në ShFMU “Ramadan Morina” në Damanek, është mbajtur një orë letrare, me rastin e kompletimit të bibliotekës shkollore, me 1010 ekzemplarë të librave. Po ashtu, në një orë letrare të organizuar sot në ShFMU. “Dëshmorët e fshatit Buabvec” në Bubavec, biblioteka e kësaj shkolle, është furnizuar me 500 ekzemplarë librash. Pajisja e bibliotekave shkollore, me libra, është iniciativë e shkrimtarit Mehdi Krasniqi (i cili është edhe zyrtar për rini në Komunën e Malishevës), ndërsa aksionit të tij, i janë bashkuar shumë shkrimtar, shtëpi botuese dhe dashamir të librit.

Orët letrare të mbajtura sot në këto dy shkolla, janë organizuar nga SHKL “Tafil Kelmendi” dhe janë mbështetur nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Me këtë rast, shkrimtari Krasniqi, i ka falënderuar të gjithë krijuesit letrat, edituesit e shtëpive



botuese, DAE dhe DKRS në Malishevë dhe të gjithë adhuruesit e librit, që e kanë përkrahur. Të gjithë dhuruesit e librave, kanë nderuar me mirënjohje nga ana e Drejtoria për Arsim dhe Edukim dhe Drejtoria për Kulturë. Rini dhe Sport në Malishevë

Përndryshe, me iniciativë të Mehdi Krasniqit, janë grumbulluar në një sasi e konsiderueshme e titujve të ndryshëm të librave, me qëllim të pajisjes së bibliotekave shkollore me libra, për nevoja të nxënësve të shkollave të Komunës së Malishevës.

Ditë më parë, me një mijë ekzemplarë të librave, është pajisur shkolla në fshatin Marali, pastaj shkolla e Damanekut me 1010 ekzemplarë, shkolla e Bubavecit me 500 ekzemplarë dhe shumë shpejt edhe një shkollë tjetër do të furnizohet me 500 ekzemplarë.

Begaj e Gecaj përruruan nënkalinimin në Dragobil

Malishevë, 20 dhjetor

Me një ceremoni rasti, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe zëvendësministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kanë përruar nënkalinimin në fshatin Dragobil. Ky nënkalinim, është ndërtuar afër shkollës së fshatit, dhe është ndërtuar me qëllim të sigurisë së nxënësve të fshatrave Dragobil, Maxharrë dhe Astrazup, të cilët mësojnë në këtë shkollë dhe cila gjendet në anën tjetër të magjistrales.

Zëvendësministri Gecaj dhe kryetari Begaj, u shprehën të kënaqur me ndërtime e këtij nënkalimi, projekt i realizuar në bashkëpunim mes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Malishevës. Me këtë rast, i kanë uruar nxënësit e shkollës dhe kanë shprehur kënaqësinë e tyre, pasi nga tani, nxënësit e kësaj shkolle, janë të sigurt gjatë rrugës për në shkollë. Shiritin e përrimit, e kanë prerë, kryetari Begaj, zv/ministri Gecaj dhe drejtori i shkollës, Zyber Paçarizi. Ky i fundit, i ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe MAPL-në, për këtë investim domethënës.

Ndërtimi i përbashkët i këtij nënkalimi, ka kushtuar rreth tridhjetë mijë euro dhe është financuar nga MAPL dhe Komuna e Malishevës.

Paraprakisht, kryetari Begaj, zëvendësministrin Gecaj, e ka pritur në zyrën e tij, ku kanë diskutuar për çështje të ndryshme. Me këtë rast, Begaj dhe Gecaj, u pajtuan për rritjen e



bashkëpunimin. Kryetari Begaj, ka kërkuar nga zv/ministri Gecaj, angazhimin e tij personal në zgjidhjen e problemit të regjionit dhe kthimin me regjionin e Prizrenit. Gjithashtu Begaj, ka shprehur shqetësimin e tij, për mosfunksionimin e ueb faqeve të komunave, si dhe kërkoj përkrahje më të madhe për Malishevën, si komunë e barabartë me komunat tjera.

Zëvendësministri Gecaj, tha se do të angazhohet në këtë drejtim. “Krahas vullnetit të qytetarëve të Malishevës, është edhe vullneti i të gjitha subjekteve politike, për rikthim me regjionin e Prizrenit dhe unë do të angazhohem personalisht në këtë drejtim”, tha Gecaj. Sa i përket investimeve nga kjo ministri, Gecaj tha se do të trajtohen të gjitha komunat në mënyrë të barabartë, kurse për mosfunksionimin e ueb faqeve, tha se shumë shpejt do të zgjidhet ky problem.

Kryetari Begaj, mbajti takimin e dytë publik me qytetarë

Malishevë, 22 dhjetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e dytë publik me qytetarë, ku ka prezantua punën e tij njëvjeçare. Sipas kryetarit Begaj, këtë vit kanë arritur që në përgjithësi ti realizojnë objektivat e caktuara, duke realizuar rreth pesë milion euro investime kapitale. Infrastruktura e përgjithshme, shkollat dhe bujqësia, kanë qenë prioritete gjatë këtij viti, ku edhe investimi ka qenë më i madh.

“Rrugët, kanalizimet, ndërtimi i ujësjellësve, shkollat, bujqësia dhe shëndetësia, kanë qenë fokusi ynë kryesor dhe ne jemi munduar që sadopak ti përmbushim këto nevoja përmes investimeve direkte dhe të gjitha këto janë të prekshme për të gjithë. Gjatë këtij viti, kemi ndërtuar mbi 20 kilometra kanalizim, rreth 22 kilometra rrugë, pastaj janë ndërtuar 10 stalla, janë përkrahur bujqit me serra, dhe investime tjera. Po ashtu, jemi duke punuar në ndërtimin e objekteve të reja shkollore”, tha kryetari Begaj, gjatë prezantimit të punëve të kryera gjatë këtij viti.

Më pas, kryetari Begaj, në formë kronologjike, nga janari e deri më sot, i ka prezantuar të gjitha investimet kapitale, të cilat edhe janë shfaqur në mënyrë vizuale para të pranishmëve, përfshi edhe të gjitha kontratat nga sektori i prokurimit publik. Bazuar në këto të dhëna, Komuna e Malishevës, gjatë këtij viti ka realizuar mbi pesë milion euro investime, prej tyre 3.8 milion investime nga buxheti komunal dhe 1.5 milion nga donatorët.

Pas prezantimit, kryetari Begaj është përgjigjur edhe në pyetjet e të pranishmëve.



Rregullimi i kanalizimeve, si në Janqisht, Berishë e Llapqevë, ishin kërkesat kryesore, ndërsa u kërkua edhe investim në trotuare dhe objekte shkollore, si dhe hapja dhe asfaltimi i disa rrugicave në fshatrat e Komunës së Malishevës.

U dha shfaqja edukative për fëmijë “Palaqo i Ati, Palaqo i Biri”

Malishevë, 22 dhjetor

Sot, në kuadër të festimeve për fund vit, në Shtëpinë e Kulturës, u dha shfaqja komedi, me karakter edukativo-arsimor “Palaqo i Ati, Palaqo i Biri”, me aktorët e mirënjohur Fazli Muharremi dhe Mirsad Ferati, me regji të Marigona Beketeshi. Kjo shfaqje teatrale është realizuar në bashkëpunim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Malishevë dhe “Mitrix kulture”.

Shfaqjen e kanë përcjellë një numër i madh i fëmijëve, ndërsa edhe shfaqja, duket se e kishte arritur qëllimin e saj, pasi gjatë tërë shfaqjes aktorët, përmes aktrimit, arrinin të komunikonin me publikun dhe e tërë shfaqja, është realizuar duke komunikuar me publikun.

Përmes kësaj shfaqjeje, u dhanë mesazhe për fëmijët, që duhet të mësojnë, të dëgjojnë prindërit, të mos bëjnë probleme dhe sa më pak të përdorin telefon (celular). Këtë mesazh, aktorët Muharremi dhe Ferati, e kanë përcjellë në mënyrë të shkëlqyer tek fëmijët.

Kryetari Begaj, i falënderoi punëtorët shëndetësor për punën e tyre humane

Malishevë, 29 dhjetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, në kuadër të përmbylljes së këtij viti, i kanë pritur punëtorët shëndetësorë, nga Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare (QKMF) “Dr.Shpëtim Robaj” në Malishevë, të cilët i kanë falënderuar dhe përgëzuar për punën e tyre humane që janë duke bërë, në shërbim të qytetarëve.

“Unë ju përgëzoi për punën tuaj, sa humane aq edhe të rëndësishme, që jeni duke bërë për qytetarët e Komunës së Malishevës, duke ju ofruar shërbimet dhe profesionalizmin tuaj, në



shëndetësi. Puna juaj, jo vetëm humane, por është edhe mbi interesin material. Angazhimi i të gjithë stafit shëndetësor në luftimin e EHKK, pastaj shërbimet tjera, në të gjitha mundësitë që ka QKMF-ja, neve na obligon që ta përkrahim këtë sektor dhe të jemi në shërbimin tuaj. Unë ju përgëzoi për gjithë punën që jeni duke bërë dhe ju dëshiroj suksese në punën e juaj, në shërbim të qytetarëve”, tha mes tjerash, kryetari Begaj.

Ndërsa drejtori komunal për shëndetësi, Hajdin Berisha, pasi i përgëzoi të gjithë për punën dhe angazhimin e tyre, i ndau tri momente me shumë rëndësi gjatë këtij viti: Kontributi në parandalimin dhe trajtimin e EHKK, vizitat sistematike shëndetësore në shkolla dhe ndarja e çmimit për kontribut në shëndetësi për njësinë e emergjencës, pikërisht për parandalimin e EHKK, janë shumë domethënëse dhe me rëndësi në sektorin e shëndetësisë. Drejtori Berisha, e njoftoi stafin e QKMF-së edhe me angazhimin e drejtorisë në hartimin e statutit të QKMF-së, bazuar në ligjet aktuale dhe nevojat e QKMF-së, statut i cili pritet të finalizohet shumë shpejt.

Në emër të stafit të QKMF-së, ushtruesi i detyrës së drejtorit, Milazim Kryeziu, i falënderoi të gjithë punëtorët për punën që po bëjnë, si dhe komunën për përkrahjen e vazhdueshme në plotësimin e nevojave të QKMF-së. Sipas Kryeziut, QKMF e Malishevës i ka shërbimet më të shpejta për qytetarë dhe shërbimet janë profesionale në të gjithë sektorët. Kryeziu, i ka falënderuar të gjithë punëtorët shëndetësorë për punën dhe angazhimin e tyre, si dhe Komunën e Malishevës, për mbështetje, ndërsa tha se “këto shërbime do të vazhdojnë të jenë në nivel edhe më të lartë, gjithmonë në ruajtjen dhe kujdesin e shëndetit të të gjithë banorëve të Komunës së Malishevës”.

Deputetja Bytyqi, shpërndau dhurata për fëmijët e çerdhes

Malishevë, 30 dhjetor

Sot, deputetja e Kuvendit të Kosovës, Shukrije Bytyqi, që vjen nga Komuna e Malishevës, i shoqëruar edhe nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit Avdi Morina dhe drejtoresha për kulturë, Blerta Krasniqi, kanë vizituar çerdhen për fëmijë, dhe me këtë rast deputetja Bytyqi, ka shpërndarë dhurata për të gjithë fëmijët e çerdhes.

Deputetja Bytyqi dhe kryetari Begaj, i kanë uruar fëmijët me rastin e vitin të ri, ndërsa stafin e çerdhes, e kanë përgëzuar për punën e palodhshme që janë duke bërë më këta fëmijë.



Kryetari Begaj, vizitioi njësinë e KEDS-it në Malishevë

Malishevë, 30 dhjetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka vizituar njësinë e KEDS-it në Malishevë, ku është pritur nga përgjegjësi i njësisë, Dardan Krasniqi. Kryetari Begaj, i ka uruar punëtorët e KEDS-it, me rastin e vitit të ri, ndërsa është njoftuar edhe me punën e kësaj njësie të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përgjegjësi Krasniqi, e ka njoftuar kryetarin me punën e kësaj njësie, ndërsa ka njoftuar se gjatë festave do të ketë furnizim të mirë me energji elektrike, duke përjashtuar mundësinë e ndonjë avarie apo mbingarkese që mund të shkaktohet, pasi rrjeti i shpërndarjes nuk është në gjendje të kënaqshme.

Begaj e Krasniqi, i kanë uruar të gjithë punëtorët e njësisë në Malishevë, me rastin e vitit të ri 2017.

Begaj: Puna dhe sukcesi, meritë e përbashkët

Malishevë, 30 dhjetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e fundit të Këshillit të Drejtorëve dhe me këtë rast i ka përgëzuar të gjithë drejtorët e drejtorive për punën e përbashkët të bërë gjatë këtij viti. Të gjitha sukseset dhe puna e bërë, janë meritë e përbashkët e të gjithëve.

“Jemi munduar që përmes investimeve, ti plotësojmë të gjitha kërkesat e qytetarëve të Komunës së Malishevës, duke bërë përpjekje për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve. Po ashtu edhe shërbimet komunale kanë qenë në nivel të mirë dhe nuk kemi asnjë rast të ankesave për kryerjen e shërbimeve, duke na bërë njëra prej komunave më të mira. Edhe në fushën e transparencës dhe shpenzimit të buxhetit, gjithashtu renditemi ndër komunat më të mira, sikur edhe në aspektin e sigurisë. E gjithë kjo është meritë e përbashkët e qeverisjes sonë. Të njëjtin angazhim, apo angazhim edhe më të madh, kërkoj nga të gjithë ju, edhe në vitin 2017, në mënyrë që të jemi sa



më shumë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Malishevës”. tha mes tjerash, kryetari Begaj, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Drejtorëve për vitin 2016.

Kryetar i Komunës, takoi të gjithë punëtorët e administratës komunale

Malishevë, 30 dhjetor

Ashtu sikur është tradita në Komunën e Malishevës, Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, ka takuar të gjithë punëtorët e administratës komunale, me rastin e fundvitit. Kryetari Begaj, i ka falënderuar të gjithë për punën dhe angazhimin e tyre gjatë vitit 2016.

“Puna juaj, përkushtimi juaj, serioziteti dhe profesionalizmi në punë, ka qenë evident gjatë këtij viti dhe unë me këtë rast, ju përgëzoj të gjithëve dhe ju falënderoj për punën e bërë. Uroj që viti 2017 të jetë një vit i mbarë për të gjithë ju, familjet e juaja dhe të gjithë banorët e Komunës së Malishevës”, tha Begaj.

Hoti e Buzhala, sportistët e vitit të Malishevës

Malishevë, 30 dhjetor

Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka shpallur sot më të mirët e vitit në këto fusha. Më interesante ishte fusha e sportit, duke mos i anashkaluar as aktivitetet tjera ku janë treguar rezultate. Për të gjitha të arriturat në sport, rini, kulturë dhe lexim, kryetari i Malishevës, Begaj dhe drejtoresha Krasniqi, i kanë përgëzuar sportistët, vullnetarët e rinisë, ata që dhanë kontribut në kulturë, lexuesit dhe mërgimtarët donator në sportin e Malishevës.

“Unë shprehi mirënjohjen time për të gjithë ju, që në mënyrën më të mirë të mundshme e keni përfaqësuar Malishevën dhe Kosovën në të gjitha këto fusha”, tha Begaj, ndërsa drejtoresha



Blerta Krasniqi, gjithashtu shprehi mirënjohjen e saj dhe i “përgëzoj të gjithë për të gjitha të arriturat në këto fusha”.

Sportistë të vitit janë shpallur Albion Hoti, atlet me 23 medalje, disa rekorde nacionale dhe medalje në garat ndërkombëtare, si dhe Ideal Buzhala, notar, me 23 medalje të arta në garat e ndryshme të notit.

Komuna ndihmoi 277 familje me ndihma dhe ka dhënë 100 dhurata për fëmijë

Malishevë, 30 dhjetor

Komuna e Malishevës, në kuadër të përkrahjes për familjet në nevojë, ka dhënë 277 pako ushqimore për këto familje, si dhe i ka shpërnda 100 dhurata, për fëmijë me nevoja të veçanta. Sipas nënkryetarit të Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, këto ndihma jepen rregullisht, ndërsa kësaj radhe janë ndihmuar me rastin e festës së ndërrimit të moteve.

Nënkryetari Mazreku, ka bërë të ditur se 277 familje janë ndihmuar me pako ushqimore, ky hynë familjet e dëshmorëve që kane nevojë, pastaj kategoritë sociale, të cilët kanë jetojnë në kushte jo të mira.

Po ashtu, sipas Mazrekut, janë shpërnda dhurata për fëmijët me nevoja të veçanta.

Kryetari Begaj, vizitoi shërbimet emergjente në Malishevë

Malishevë, 31 dhjetor

Sonte, në kuadër të festimeve të ndërrimit të viteve, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Sejdi Paçarizi dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Hajdin Berisha, i kanë vizituar shërbimet emergjente në Malishevë, Policinë e Kosovës, Emergjencën e QKMF-së dhe Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit.



Kryetari Begaj dhe drejtorët Paçarizi e Berisha, i kanë falënderuar dhe përgëzuar këto shërbime, të cilët edhe në natën e ndërrimit të viteve, janë shërbim të qytetarëve.